

LIGJ
Nr. 79/2020

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të garantojë ekzekutimin e vendimeve penale në përputhje me legjislacionin në fuqi, me standardet ndërkombëtare dhe në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 2

Objekti i ligjit

1. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ekzekutimin e:
 - vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë;
 - vendimeve gjyqësore penale me ekzekutim të menjëhershëm;
 - urdhërimeve të tjera me vendime gjyqësore, si dhe;
 - përcaktimin e mënyrës së kryerjes së dënimeve alternative sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të dhëna nga gjykatat vendase dhe të huaja në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

Neni 3

Parimet kryesore gjatë ekzekutimit të vendimit penal

1. Ky ligj zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë personat e arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar, duke shmangur diskriminimin dhe format e sjelljes që e nxisin atë, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.
2. Gjatë ekzekutimit të vendimit penal sigurohet:
 - a) ligjshmëria, përgjegjësia, paanshmëria dhe proporcionaliteti në veprimtarinë e subjekteve të këtij ligji;

b) trajtimi human dhe respektimi i të drejtave dhe dinjitetit të personit të arrestuar, të paraburgosur ose të dënuar;

c) pjesëmarrja e personit të dënuar në risocializimin dhe riintegrimin e tij shoqëror, përmes planifikimit të dënimit, si dhe bashkëpunimit të shoqërisë në arritjen e qëllimeve të tilla.

Neni 4

Parimi i zbatimit vullnetar

Vendimi penal vihet në ekzekutim vullnetarisht nga i dënuari në mënyrën, kohën dhe vendin e caktuar nga organi kompetent sipas këtij ligji. Vetëm në rast refuzimi të zbatimit vullnetar të tij, bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit penal.

Neni 5

Të drejtat e të arrestuarit, të paraburgosurit dhe të dënuarit gjatë ekzekutimit të vendimit penal

1. Ekzekutimi i vendimit penal kufizon vetëm ato të drejta, në atë masë dhe kohë sa përcakton vendimi penal, duke respektuar të gjitha të drejtat e tjera të njohura dhe të mbrojtura nga legjislacioni në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

2. Personi në të gjitha fazat e ekzekutimit të vendimit penal, gëzon të drejtat e parashikuara në legjislacionin procedural penal dhe në ligjet e tjera në fuqi. Në rast të cenimit të të drejtave dhe kur nuk i njihen ato, personi kërkon mbrojtjen dhe realizimin e tyre në mënyrën që përcaktohet në legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Ekzekutimi i vendimeve penale për të miturit dhe gratë

1. Ekzekutimi i vendimeve penale për të miturit kryhet në përputhje me rregullat procedurale të parashikuara në këtë ligj, në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në Kodin e Procedurës Penale.

2. Ekzekutimi i vendimeve penale për gratë kryhet duke respektuar mbrojtjen e dinjitetit, nevojat e tyre fizike, sociale, profesionale, shëndetësore dhe psikologjike.

Neni 7

Përgjegjësia e subjekteve të ekzekutimit të vendimit penal

1. Subjektet e ngarkuara me ekzekutimin e vendimit penal sipas këtij ligji, ushtrojnë kompetencat duke respektuar të drejtat, dinjitetin dhe liritë e personit.

2. Punonjësi i ngarkuar për ekzekutimin e vendimit penal mban përgjegjësi disiplinore dhe, kur është rasti, edhe penale, për mosvënien, zvarritjen ose ekzekutimin e vendimit në kundërshtim me ligjin ose të drejtat e personit.

Neni 8

Përgjegjësitë e prokurorit

Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit penal në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji, si dhe të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit. Në rast të konstatimit të parregullsive, prokurori ka të drejtë t'i kërkojë organit përgjegjës ose gjykatës rivendosjen e të drejtës së shkelur, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.

Neni 9

Detyrimi për njoftimin e fakteve dhe rrethanave

1. Çdo person apo subjekt i urdhëruar nga prokurori për ekzekutimin e një vendimi penal, që gjatë procedurës së ekzekutimit është në dijeni të fakteve dhe rrethanave, të cilat ndikojnë në mënyrën dhe kohën e ekzekutimit të vendimit penal, ka detyrimin të njoftojë prokurorin.

2. Mosnjoftimi i prokurorit, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet nga gjykata me gjobë deri në 100 (njëqind) mijë lekë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Me marrjen në dijeni të fakteve e rrethanave të reja, prokurori pasi bën verifikimin, sipas rastit, ndërhyr bazuar në dispozitat e këtij ligji ose paraqet kërkesë në gjykatën kompetente.

4. Kur fakti ose rrethana ndikon në bazueshmërinë ose ligshmërinë e vendimit penal, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

PJESA E DYTË

VËNIA NË EKZEKUTIM E VENDIMEVE PENALE

KREU I

KOMPETENCAT PËR VËNIEN NË EKZEKUTIM

Neni 10

Gjykata

Gjykata në vendimet me ekzekutim të menjëhershëm, veç disponimeve të tjera, urdhëron vënien në ekzekutim të vendimit menjëherë pas shpalljes dhe dërgimin e një kopjeje të vendimit prokurorit pranë gjykatës që ka dhënë vendimin për ekzekutimin e tij.

Neni 11

Prokurori

1. Prokurori merr masa dhe vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal dhe, në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit, sipas këtij ligji.

2. Prokurori mban dosje të veçantë për ekzekutimin e vendimit dhe për të gjitha aktet e administruara gjatë ekzekutimit.

Neni 12

Urdhri i ekzekutimit

1. Urdhri i ekzekutimit është akti procedural që nxjerr prokurori për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor penal. Urdhri i ekzekutimit përmban:

a) gjykatën që ka dhënë dhe/ose ka ndryshuar vendimin penal numrin, datën, përmbajtjen e plotë të dispozitivit të vendimit penal objekt ekzekutimi dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin;

b) gjeneralitetet e personit ndaj të cilit do të ekzekutohet vendimi penal, adresën e vendbanimit ose të vendqëndrimit, pranë së cilës do të kryhet njoftimi i urdhrit të ekzekutimit;

c) llojin dhe masën e dënimit kryesor, si dhe kohëzgjatjen tërësore të kryerjes së dënimit, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe rregullave të parashikuara në këtë ligj;

ç) llojin e dënimit plotësues dhe kriteret e zbatimit të tij;

d) në rastet e dënimit me burgim, llojin e sigurisë që duhet të ketë vendi i kryerjes së dënimit, sipas përcaktimit të bërë nga gjykata në dispozitivin e vendimit penal kryesisht ose bazuar në kërkesën e prokurorit për përcaktimin e llojit të sigurisë, sipas nenit 24 të këtij ligji;

dh) detyrimin civil në procesin penal;

e) organet që ekzekutojnë vendimin;

ë) detyrimin e organeve që ekzekutojnë vendimin penal për njoftimin e fillimit të ekzekutimit. Në rastin e të dënuarve të mitur ose me aftësi të kufizuara përcaktohet edhe mënyra e njoftimit të urdhrin të ekzekutimit.

2. Prokurori pranë gjykatës së apelit ose Gjykatës së Lartë, menjëherë pas administrimit të vendimit përmbledhës, ia dërgon zyrtarisht prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, e cila ka përgjegjësinë e ekzekutimit të vendimit.

3. Urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e dënimit. Në rastin e të miturve, urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë në të cilën është ngritur seksioni për të mitur.

Neni 13

Njoftimi i të dënuarit dhe mbrojtësit të tij

1. Urdhri i ekzekutimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 30 ditë, të dënuarit, mbrojtësit të tij dhe, kur nuk ka të tillë, mbrojtësit të caktuar nga prokurori.

2. Njoftimi i urdhrin të ekzekutimit për personat e mitur bëhet në mënyrë të tillë që informacioni të jetë i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për ta, duke mbajtur parasysh nevojat e të miturit me aftësi të veçanta. Prokurori njofton paraprakisht përfaqësuesin ligjor apo procedural ose një person tjetër të rritur, të treguar dhe pranuar prej të miturit, si dhe psikologun ose punonjësën e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, kur rasti është trajtuar nga kjo e fundit.

3. Për të dënuarit me fëmijë të mitur, prokurori njofton bashkëshortin dhe, në rast pamundësie të tij ose kur nuk dihet ku ndodhet, njësinë për mbrojtjen e fëmijës së vendbanimit të të dënuarit.

Neni 14

Shpërblimi i dëmit

1. Viktima e veprës penale, së cilës i është njohur e drejta për shpërblimin e dëmit me vendim gjyqësor të formës së prerë, kërkon vënien në ekzekutim të vendimit që përmban urdhërime në favor të tij, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile. Prokurori detyrohet të njoftojë viktimën e veprës penale për fillimin e ekzekutimit të vendimit penal.

2. Urdhërimet e vendimit penal për të drejta pasurore në favor të shtetit ekzekutohen sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, duke njoftuar paraprakisht Avokaturën e Shtetit.

3. Prokurori ka të drejtë të informohet në çdo kohë për ekzekutimin e të drejtave pasurore shtetërore që rrjedhin nga një vendim penal.

4. Kur prokurori konstaton se organi kompetent shtetëror nuk merr masa, i drejtohet gjykatës për të kërkuar vënien në ekzekutim të të drejtave pasurore që rrjedhin nga vendimi penal, sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile.

KREU II

SUBJEKTET QË EKZEKUTOJNË VENDIMIN PENAL TË FORMËS SË PRERË

Neni 15

Detyrat e Policisë së Shtetit

1. Policia e Shtetit është përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve penale të mëposhtme:

a) dënimit me burgim për personat në gjendje të lirë;

b) dënimeve plotësuese, të parashikuara në pikat 3, 7, 8 e 10 të nenit 30 të Kodit Penal.

2. Policia e Shtetit, mbi bazën e urdhrit të prokurorit, në bashkëpunim me seksionet e Policisë Gjyqësore në prokurori dhe me shërbimet e Policisë Gjyqësore në strukturat hetimore në Policinë Ushtarake, si dhe me shërbime të tjera policore ose institucione shtetërore, ndihmon për ekzekutimin vullnetar të dënimit me burgim ose në të kundërt vepron forcërisht për ekzekutimin e këtij dënimi.

3. Policia e Shtetit, në bazë të një kërkesë ose me nismën e vet, mbështet veprimet e seksioneve të Policisë Gjyqësore, shërbimeve të Policisë Gjyqësore në strukturat hetimore të Policisë Ushtarake, të shërbimeve të tjera policore ose institucioneve shtetërore, Policisë së Burgjeve, Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara dhe të organeve të tjera përkatëse të ngarkuara sipas këtij ligji, për ekzekutimin e vendimeve penale, që kanë marrë formë të prerë apo që kanë ekzekutim të menjëhershëm.

Neni 16

Ekzekutimi nga shërbimi i përmbaarimit gjyqësor

Shërbimi i përmbaarimit gjyqësor ekzekuton dënimin me gjobë, shpenzimet gjyqësore dhe detyrimin civil, të caktuar në vendimin penal.

Neni 17

Shërbimi i Provës

Shërbimi i Provës është organi shtetëror, përgjegjës për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe urdhërimeve të prokurorit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, të masave të shmangies nga ndjekja penale, të dënimeve jo me burgim për të miturit, ose veprimtarive të tjera sipas akteve të tjera ligjore, si dhe trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit nën mbikëqyrje për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

Neni 18

Ekzekutimi nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, mbi bazën e urdhrit të prokurorit dhe nën mbikëqyrjen e tij, ekzekuton dënimin plotësues të konfiskimit të mjeteve të kryerjes dhe produkteve të veprës penale, të parashikuar nga pika 2 e nenit 30 të Kodit Penal.

Neni 19

Ekzekutimi nga organet shtetërore dhe personat juridikë

Vendimet që përmbajnë dënime plotësuese të parashikuara nga pikat 1, 4, 6 dhe 10 të nenit 30 të Kodit Penal ekzekutohen nga organet përkatëse shtetërore ose personat e tjerë juridikë, shtetërore ose privatë, mbi bazën e urdhrit të ekzekutimit.

Neni 20

Ekzekutimi i dënimit plotësues nga i dënuari

1. Dënimi plotësues për publikimin e vendimit gjyqësor, i parashikuar në pikën 9 të nenit 30 të Kodit Penal, ekzekutohet vullnetarisht nga vetë i dënuari sipas urdhërimit të gjykatës.

2. Në rast mosveprimi prej tij, vendimi ekzekutohet nga prokurori me shpenzimet e të dënuarit.

Neni 21

Njoftimet gjatë ekzekutimit

1. Organet kompetente për ekzekutimin e vendimit penal njoftojnë prokurorin për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit të vendimit.
2. I dënuari njofton prokurorin për ekzekutimin e publikimit të vendimit, sipas nenit 20 të këtij ligji.
3. Në raste të veçanta, kur kërkohet nga prokurori, bëhen njoftime periodike edhe gjatë ekzekutimit të vendimit penal.
4. Prokurori njofton me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin për fillimin e ekzekutimit, si dhe për përfundimin e tij.

PJESA E TRETË

MËNYRAT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

KREU I

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE QË NUK KANË MARRË FORMË TË PRERË

Neni 22

Ekzekutimi i menjëhershëm

1. Ekzekutohen me urdhër të gjykatës, menjëherë pas shpalljes:
 - a) vendimi penal që përmban pafajësi, përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi ose pushimin e gjykimit të çështjes, me disponimin për lirimin e personit të paraburgosur, sipas nenit 389 dhe pikës 2 të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale;
 - b) vendimi penal për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim, ku përfshihet personi me masë sigurimi arrest, me disponimin e gjykatës për lirimin e menjëhershëm të tij;
 - c) vendimi penal që përmban konfiskim pasurie, kur më parë është vendosur sekuestrimi;
 - ç) vendimi për paligjshmërinë e arrestit në flagrancë/ndalimit, vendimi kur masa e sigurimit e humbet fuqinë ose vendimi për revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit me arrest, me disponimin e gjykatës për lirimin e menjëhershëm të personit të arrestuar, përveç kur ai ka një masë sigurimi me arrest për shkak tjetër ligjor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale;
 - d) vendimi penal që miraton kërkesën e prokurorit për masën e sigurimit me arrest.
2. Për ekzekutimin e menjëhershëm, gjykata i njofton prokurorit vendimin e përmbledhur. Prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin nxjerr menjëherë urdhrin, i cili vihet në ekzekutim nga organet përgjegjëse, pasi të kenë verifikuar më parë që ndaj të njëjtit person ose të njëjtës pasuri nuk janë në fuqi vendime penale të tjera, që legjitimojnë vazhdimin e mbajtjes së personit nën arrest, ndalim, paraburgim ose burgim apo mbajtjen e pasurisë nën sekuestro ose konfiskim.
3. Për ekzekutimin e menjëhershëm, gjykata i jep paraprakisht organit përkatës vendimin e përmbledhur dhe brenda afatit ligjor dërgon vendimin penal të arsyetuar.

KREU II

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË DHE I DËNIMEVE ALTERNATIVE

Neni 23

Veprimet paraprake të prokurorit

1. Vendimet me burgim, me marrjen formë të prerë, i dërgohen prokurorit nga gjykata sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Kur i dënuari ka qenë i paraburgosur, në urdhrin e ekzekutimit saktësohen koha e kryer e dënimit dhe pjesa që mbetet, sipas kriterëve të nenit 57 të Kodit Penal.

3. Kur i dënuari ka për të kryer më shumë se një dënim, prokurori i paraqet kërkesë gjykatës për bashkimin e dënimeve.

4. Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe kriterëve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, prokurori përcakton llojin e institucionit ku i dënuari do të kryejë dënimin dhe në konsultim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve përcakton institucionin konkret.

5. Kur gjykata nuk e ka konstatuar dhe prokurori ka të dhëna se është vendi për vendosjen në institucione mjekësore të posaçme, ai urdhëron kontrollin mjekësor të të dënuarit dhe, kur ka arsye, në bazë të rezultateve, i paraqet kërkesë gjykatës sipas parashikimeve ligjore.

Neni 24

Nxjerrja dhe dërgimi i urdhrin të ekzekutimit

1. Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe të veprimeve paraprake, sipas nenit 23 të këtij ligji, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit dhe ia dërgon organit vendor të Policisë së Shtetit ku ka vendbanimin e përhershëm apo të përkohshëm ose vendqëndrimin i dënuari.

2. Për të dënuarit ushtarakë, urdhri i dërgohet Policisë Ushtarake pranë repartit ku ka qenë efektiv i dënuari ose të vendit ku ai ndodhet.

3. Kur i dënuari është i paraburgosur, urdhri i dërgohet institucionit ku ai mbahet.

4. Kur vendbanimi apo vendqëndrimi nuk dihet, urdhri i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Neni 25

Njoftimi për ekzekutim vullnetar

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, punonjësi i Policisë Ushtarake për të dënuarit ushtarakë, ose Shërbimi i Provës, i ngarkuar për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit, njofton të dënuarin, duke i caktuar kohën dhe vendin e paraqitjes vullnetare, me paralajmërimin se në rast të mosparaqitjes vullnetare, vendimi penal do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.

2. Për të dënuarin me burgim ose me një nga alternativat e dënimit me burgim, i cili ka qenë në gjendje të lirë, ose në ngarkim të të cilit gjatë fazës së hetimit dhe gjykimin ka pasur një masë sigurimi të ndryshme nga masa e sigurimit “arrest në burg”, njoftimi kryhet në vendbanimin ose vendqëndrimin e të dënuarit. Për këtë qëllim mbahet procesverbal, i cili i dorëzohet të dënuarit personalisht dhe, kur kjo nuk është e mundur, familjarëve të tij. Kur kjo mënyrë njoftimi nuk është e mundur, njoftimi bëhet nëpërmjet strukturave vendore të Policisë së Shtetit ku i dënuari ka vendbanimin.

3. Njoftimi për ekzekutimin vullnetar të dënimit me burgim përmban:

a) numrin dhe datën e urdhrin të ekzekutimit të prokurorit;
b) numrin dhe datën e vendimit penal;
c) llojin dhe masën e dënimit të përlllogaritur nga prokurori në urdhrin e ekzekutimit;
ç) datën, orën dhe vendndodhjen e institucionit ku i dënuari duhet të paraqitet vullnetarisht për të kryer dënimin;

d) paralajmërimin se, në rast mosparaqitje vullnetare në datën, orën dhe vendin e caktuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.

4. Afati i paraqitjes vullnetare në institucionet e caktuara për kryerjen e dënimit nuk mund të jetë më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit.

5. Vendimi gjyqësor për vendosjen e personit nën mbikëqyrje elektronike u dërgohet menjëherë prokurorit, Shërbimit të Provës dhe Policisë së Shtetit, të cilët bashkëpunojnë për ekzekutimin dhe monitorimin e zbatimit të vendimit.

Neni 26

Shtyrja e ekzekutimit të vendimit

Ekzekutimi i vendimit të dënimit mund të shtyhet nga gjykata që ka dhënë vendimin, me kërkesë të të dënuarit, mbrojtësit të tij ose prokurorit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Kur gjykata vendos shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve, prokurori administron vendimin dhe ndërpret veprimet procedurale për vënien në ekzekutim të vendimit.

Neni 27

Ekzekutimi i detyrueshëm

1. Kur i dënuari nuk paraqitet në datën dhe vendin e caktuar, sipas njoftimit vullnetar, bëhet ekzekutimi i detyruar i vendimit.

2. Me miratim të prokurorit, ekzekutimi i detyrueshëm zbatohet menjëherë, kur ka arsye të mendohet se i dënuari mund t'i shmanget ekzekutimit ose mund të cenohet rendi dhe siguria publike.

3. Ekzekutimi i detyruar realizohet duke dërguar forcërisht të dënuarin në vendin e caktuar për kryerjen e dënimit. Përpara përdorimit të forcës ose mjeteve shtrënguese, i dënuari ftohet verbalisht për ekzekutim vullnetar.

4. Forca fizike dhe mjetet shtrënguese përdoren në masën dhe mënyrën proporcionale, që u përgjigjen veprimeve kundërshtuese të dënuarit dhe synojnë paralizimin e veprimeve dhe jo ndëshkimin e tij.

5. Lloji i mjeteve shtrënguese përcaktohet sipas dispozitave që rregullojnë veprimtarinë e organit që ekzekuton vendimin.

6. Për përdorimin e forcës fizike dhe mjeteve të shtrëngimit, gjatë ekzekutimit të detyruar hartohet një raport, ku jepen arsyet, faktet dhe rrethanat që kanë diktuar nevojën e përdorimit të forcës, si dhe njoftohet prokurori menjëherë pas kryerjes së veprimit.

7. Ekzekutimi i detyruar forcërisht zbatohet vetëm për dënimet me burgim dhe për dënimet plotësuese të parashikuara nga pikat 2 dhe 8 të nenit 30 të Kodit Penal.

8. Për të gjitha llojet e dënimeve të tjera, në rast mosparaqitjeje ose shmangieje nga ekzekutimi, prokurori paraqet kërkesë për ndryshimin e llojit të dënimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 28

Dërgimi në vendin e kryerjes së dënimit

1. Me paraqitjen vullnetare të të dënuarit ose me marrjen e tij forcërisht, organi i ngarkuar e shoqëron atë në institucionin e caktuar të kryerjes së dënimit.

2. Mënyra e kryerjes së dënimit me burgim dhe të drejtat e të dënuarit përcaktohen sipas ligjit që rregullon trajtimin e të dënuarve me burgim apo të paraburgosurve.

Neni 29

Kërkimi i të dënuarit

Kur i dënuari nuk gjendet ose është larguar në drejtim të paditur, prokurori kryen veprimet e parashikuara në nenin 247 të Kodit të Procedurës Penale, për kërkimin e personit dhe, kur është rasti, edhe ato në nenin 504 të këtij Kodi.

Neni 30
Lirimi i të burgosurit

1. Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur:
 - a) përfundon kryerjen e dënimit;
 - b) i falet dënimi i mbetur;
 - c) amnistohet vepra penale apo dënimi i mbetur;
 - ç) lirohet me vendim gjykate.
2. I dënuari nuk lirohet kur ndaj tij ka filluar një procedim penal dhe është vendosur një masë sigurimi me arrest për një vepër tjetër penale të ndryshme nga ajo për të cilën po kryen dënimin.
3. Kur personi i dënuar lirohet, sipas parashikimeve të shkronjave “a”, “b” dhe “c” të këtij neni, procedura e lirimit kryhet nga institucioni i ekzekutimit të vendimit penal, ndërsa në rastet e tjera lirimi bëhet me urdhër ekzekutimi të prokurorit. Në këto raste njoftohet dhe bashkërendohet puna me Policinë e Shtetit, që, sipas rastit, merr masa për njoftimin dhe sigurimin e jetës dhe shëndetit të viktimës së veprës penale.

Neni 31
Ekzekutimi i vendimit në gjysmëliri

1. Kur gjykata vendos ekzekutimin e vendimit me burgim në gjysmëliri, parashikuar në nenin 58 të Kodit Penal, i dërgon menjëherë vendimin e përmbledhur prokurorit për ekzekutim.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës, në bazë të detyrimeve të të dënuarit apo nevojave për trajtim ose rehabilitim mjekësor të tij, përcakton institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri.

Neni 32
Mbikëqyrja e të dënuarit me gjysmëliri

1. Mbikëqyrja e të dënuarit me gjysmëliri kryhet nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale deri sa ai është i burgosur dhe nga Shërbimi i Provës, kur i dënuari ndodhet jashtë institucionit.
2. Shërbimi i Provës harton programin ditor që duhet të zbatojë personi i dënuar për periudhën kohore që ai ndodhet jashtë institucionit.
3. Shërbimi i Provës i raporton menjëherë prokurorit dhe, kur është e nevojshme, edhe drejtorit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk përmbush detyrimet e tij lidhur me punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor për qëllimin e dënimit.
4. Kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk kthehet në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, drejtuesi i institucionit, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat për moskthimin e tij, njofton menjëherë prokurorin dhe Shërbimin e Provës. Shërbimi i Provës, pasi verifikon faktet dhe rrethanat, përgatit raport vlerësimi për prokurorin dhe gjykatën.

Neni 33
Ekzekutimi i vendimit për kryerjen e një pune në interes publik

1. Kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe me pëlqimin e të dënuarit, zëvendësimin e tij me detyrimin për kryerjen e një pune të papaguar në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar nga gjykata, parashikuar në nenin 63 të Kodit Penal, i dërgon menjëherë vendimin përkatës të përmbledhur prokurorit për ekzekutimin e dënimit alternativ.

2. Shërbimi i provës, duke pasur parasysh aftësitë dhe formimin profesional të personit të dënuar, harton dhe zhvillon një plan individual trajtimi për kryerjen e punës në interes publik.

3. Para fillimit të kryerjes së punës në interes publik, Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me subjektin pranë të cilit do të kryhet puna, i bëjnë të ditur të dënuarit rregullat e sigurimit teknik në punë. Shërbimi i Provës informon personin e dënuar për detyrimin e tij për të mbajtur kontakte dhe për të përmbushur udhëzimet e dhëna nga ky shërbim.

4. Shërbimi i provës përcakton listën e institucioneve apo shoqërive, publike apo private, ku mund të kryhet puna në interes publik.

Neni 34

Mbikëqyrja e të dënuarit që kryen punë në interes publik

1. Gjykata, me marrjen e vendimit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

2. Kontakti me Shërbimin e Provës vendoset sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës.

3. Shërbimi i Provës mbikëqyr të dënuarin, që kryen punë në interes publik.

4. Shërbimi i Provës i raporton menjëherë prokurorit kur i dënuari nuk mban kontakte me të apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera të vendosura nga gjykata.

Neni 35

Moskryerja e punës

1. Kur i dënuari nuk e kryen punën në mënyrë të rregullt, subjekti, pranë të cilit kryhet puna me interes publik, njofton menjëherë Shërbimin e Provës.

2. Me moskryerje të punës në mënyrë të rregullt kuptohet paraqitja me vonesë, mungesat pa arsye në punë ose mosrespektimi i rregullave për kryerjen, sjelljen dhe rendimentin në punë.

Neni 36

Ekzekutimi i vendimit me qëndrim në shtëpi

1. Kur gjykata vendos dënimin me qëndrim në shtëpi, parashikuar në nenin 59/a të Kodit Penal, i dërgon menjëherë për ekzekutim vendimin prokurorit dhe, në rast se ai mbahet në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, edhe drejtorisë së këtij institucioni.

2. Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të dënimit me qëndrim në shtëpi, në mënyrë të vazhdueshme, deri në kryerjen e plotë të dënimit dhe bashkëpunon, sipas rastit, me strukturat përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, shërbimet sociale, organet vendore të Policisë së Shtetit, si dhe subjekte të tjera, private ose shtetërore.

3. Shërbimi i Provës, në rastet kur gjykata pranon kërkesën për ndryshimin e vendbanimit, zbaton masat e përcaktuara në këtë vendim dhe i përcjell praktikën e ekzekutimit për të dënuarin degës territoriale të Shërbimit të Provës, ku i dënuari ka vendbanimin ose vendqëndrimin e ri.

4. Shërbimi i Provës njofton për ndryshimin e vendbanimit organet vendore të Policisë së Shtetit, si dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit.

5. Shërbimi i Provës siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për personin e dënuar nga institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat jofitimprurëse që bashkëpunojnë me të për zbatimin e vendimit me qëndrim në shtëpi.

6. Shërbimi i Provës harton plane individuale të trajtimit për personin, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi.

7. Kur personi i dënuar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata, për shkak të ndryshimit të rrethanave, Shërbimi i Provës i raporton menjëherë prokurorit.

8. Nëse personi që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi, nuk respekton detyrimet e vendosura nga gjykata, Shërbimi i Provës, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat, njofton prokurorin, i cili në varësi të shkeljes, i jep paralajmërim personit ose i drejtohet gjykatës, sipas parashikimeve të nenit 62 të Kodit Penal.

Neni 37

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë

1. Kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal, i njofton menjëherë prokurorit vendimin e përmblodhur.

2. I dënuari i vënë në provë, gjatë kohës së provës është i detyruar të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi Shërbimin e Provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata, si dhe të marrë pëlqimin nga Shërbimi i Provës për ndryshimin e vendbanimit, vendqëndrimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit.

3. Shërbimi i Provës bashkërendon punën dhe informon rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit.

4. Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit kur i dënuari nuk mban kontakte me të apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera të vendosura nga gjykata.

Neni 38

Ekzekutimi i vendimit të lirimit me kusht

1. I dënuari me burgim, në përputhje me nenin 64 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit.

2. Pas paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të të dënuarit dhe një raport individual vlerësimi për të. Në raport përcaktohen qëndrimi i të dënuarit ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale e kryer prej tij, rrezikshmëria për përsëritjen e veprës penale, rrethanat familjare dhe shoqërore, formimi arsimor e profesional, gjendja fizike dhe psikologjike e të dënuarit, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

3. Gjkata i kërkon Shërbimit të Provës të paraqesë një raport paraprak vlerësimi dhe planin individual të trajtimit të të dënuarit, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit.

4. Kur gjykata vendos lirim me kusht të të dënuarit, urdhëron lirim me kusht të menjëhershëm të dënuarit dhe dërgimin e vendimit prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, ku do të jetojë i dënuari pas lirimit, dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal.

5. Personi i liruar me kusht mban kontakte dhe i raporton rregullisht Shërbimit të Provës për përmbushjen e detyrimeve gjatë kohës së lirimit me kusht.

6. Kur personi i liruar me kusht kërkon të ndryshojë vendbanimin ose vendqëndrimin, ai duhet të njoftojë paraprakisht Shërbimin e Provës, duke paraqitur dokumentacionin përkatës që vërteton ndryshimin e vendbanimit ose vendqëndrimit.

7. Dega territoriale e Shërbimit të Provës, e cila ka mbikëqyrur deri në atë moment të dënuarin, ia përcjell praktikën e ekzekutimit për të dënuarin, degës territoriale të Shërbimit të Provës, ku i dënuari ka vendbanimin ose vendqëndrimin e ri.

8. Shërbimi i Provës njofton në lidhje me ndryshimin e vendbanimit ose vendqëndrimit organet vendore të Policisë së Shtetit, si dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit.

9. Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ato të Policisë së Shtetit. Shërbimi i Provës detyrohet të informojë me shkrim sa më parë prokurorin kur i dënuari i vënë

në provë nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose shkel kushtet apo detyrimet e tjera të vendosura nga gjykata.

KREU III EKZEKUTIMI I DËNIMEVE ALTERNATIVE

Neni 39

Ekzekutimi i dënimit alternativ

1. Kur gjykata vendos pezullimin e vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ, i dërgon menjëherë prokurorit vendimin e përmblodhur për ekzekutimin e dënimit alternativ.

2. Në qoftë se i dënuari është i burgosur, gjykata ia dërgon një kopje të vendimit edhe institucionit të ekzekutimeve të vendimeve penale ku mbahet i dënuari, për lirin e tij.

3. Në rastin kur i dënuari nuk paraqitet të nesërmen e shpalljes së vendimit, afati i ekzekutimit të dënimit alternativ fillon në momentin e kontaktit të parë të personit të vendosur në provë me Shërbimin e Provës. Kohëzgjatja e kohës së provës përcaktohet në vendimin penal.

4. Në rastin kur dënimi alternativ nuk mund të ekzekutohet për shkaqe të parashikuara në nenin 476 të Kodit të Procedurës Penale, Shërbimi i Provës informon pa vonesë prokurorin për pamundësinë e ekzekutimit të vendimit.

5. Me kërkesë të prokurorit, gjykata mund të vendosë shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit alternativ, sipas afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

6. Në ekzekutimin e dënimit alternativ, Shërbimi i Provës mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, asiston dhe këshillon të dënuarin në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe ndihmon në riintegrimin e tij shoqëror.

7. Me kërkesë të gjykatës ose të prokurorit, Shërbimi i Provës përgatit një raport për zbatimin e vendimit të gjykatës dhe të planit individual të trajtimit.

8. Kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata, Shërbimi i Provës paraqet një raport para prokurorit, i cili përmban informacion për rrethanat e shkeljes, shpjegimet e dhëna nga i dënuari, vlerësimin e punonjësit të Shërbimit të Provës dhe rekomandimin, së bashku me arsyet përkatëse, për të caktuar detyrime shtesë, për të kërkuar në gjykatë zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes apo për të ndryshuar kushtet e detyrimet për ekzekutimin e dënimit.

Neni 40

Shqyrtimi i kërkesës për ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ

1. Gjkata, në zbatim të neneve 470, 471 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, me kërkesë të prokurorit, shqyrton shkeljet e rënda ose të përsëritura të kushteve të dënimit alternativ apo mospërmbushjen e detyrimeve të dhëna dhe mund të vendosë sipas nenit 62 të Kodit Penal.

2. Gjatë periudhës që shqyrton masën e revokimit të dënimit alternativ, gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e tij dhe të urdhërojë që i dënuari të vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 41

Përfundimi i dënimit alternativ

1. Kur i dënuari kryen dënimin alternativ apo përmbush detyrimin e dhënë, Shërbimi i Provës i paraqet prokurorit raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes. Prokurori nxjerr vendim të veçantë për kryerjen e dënimit alternativ.

2. Gjykata mund të vendosë përfundimin para afatit të dënimit alternativ, me propozimin e prokurorit, në të cilin vërtetohet se i dënuari ka kryer detyrimet dhe vlerësohet se nuk është më e nevojshme për t'i zbatuar më tej ato, për të arritur qëllimin e dënimit alternativ. Kërkesa e prokurorit për përfundimin para afatit përmban të dhëna për precedentët penalë të të dënuarit, përshkrim të dinamikës së sjelljes së të dënuarit e progresin e arritur gjatë ekzekutimit të dënimit dhe arsyet e paraqitjes së kërkesës.

3. Kërkesa për përfundimin para afatit të dënimit alternativ paraqitet pasi i dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore dhe nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale, rendin publik apo palët e treta.

KREU IV EKZEKUTIMI I DËNIMEVE ME GJOBË

Neni 42 **Vënia në ekzekutim**

1. Ekzekutimi i një vendimi dënimi me gjobë bëhet me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit në masën, afatet dhe mënyrën e pagimit sipas vendimit të gjykatës.

2. Ekzekutimi bëhet nga organi përmbarimor në territorin e të cilit ka vendbanimin i dënuari, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile për titujt ekzekutivë.

3. Kur i dënuari ndryshon vendbanimin, sipas njoftimit të tij për adresën e re të vendbanimit, të verifikuar, ekzekutimi i vendimit transferohet në organin përmbarimor në territorin e vendbanimit të ri.

Neni 43 **Pamundësia ose shmangia nga ekzekutimi**

1. Kur ekzekutimi i gjobës është i pamundur tërësisht ose pjesërisht, me njoftim të organit përmbarimor, prokurori i paraqet kërkesë gjykatës së vendit të ekzekutimit për konvertimin e gjobës, duke zbatuar rregullat e nenit 467 të Kodit të Procedurës Penale.

2. Kur nuk respektohen afatet e pagimit të gjobës ose nuk njoftohet ndryshimi i vendbanimit, me kërkesë të prokurorit, gjykata e vendit të ekzekutimit vendos zëvendësimin e gjobës së mbetur sipas përcaktimeve të nenit 34 të Kodit Penal.

KREU V EKZEKUTIMI I DËNIMEVE PLOTËSUESE

Neni 44 **Vënia në ekzekutim**

1. Kur është dhënë dënimi kryesor me burgim, bashkë me të ekzekutohen edhe dënimet plotësuese të parashikuara nga pikat 2, 4, 9 dhe 10 të nenit 30 të Kodit Penal.

2. Dënimet e tjera plotësuese ekzekutohen pas kryerjes së dënimit kryesor, kur gjykata nuk ka vendosur ndryshe.

3. Prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit organit kompetent për ekzekutimin e dënimit plotësues.

Neni 45 **Përgjegjësia për veprime në kundërshtim me vendimin**

1. Kur i dënuari ose organi i ngarkuar me ekzekutimin e dënimit plotësues kryen veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës, mban përgjegjësi, sipas rastit, bazuar në nenet 320 e 321 të Kodit Penal.

2. Organet shtetërore, të cilat konstatojnë veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës, detyrohen të njoftojnë prokurorin, i cili edhe kryesisht procedon sipas ligjit.

Neni 46

Heqja e dekoratave ose titujve të nderit

1. Për vendimet që përmbajnë dënimin plotësues të parashikuar nga pika 4 e nenit 30 të Kodit Penal, prokurori ia dërgon urdhrin e ekzekutimit dhe kopje të vendimit të dënimit organit që ka akorduar dekoratën apo titullin e nderit duke i kërkuar të bëhen shënimet përkatëse, tërheqja e shenjës dalluese dhe e dëshmisë origjinale nga i dënuari.

2. Kur për shkak të dekoratës apo të titullit të nderit ka privilegje apo përfitime, organi i mësipërm njofton organet përkatëse për ndërprerjen e tyre.

Neni 47

Ndalimi për të drejtuar automjete

1. Organet e Policisë së Shtetit, në bazë të urdhrin të prokurorit, bëjnë shënimet në regjistrat përkatës dhe i tërheqin të dënuarit lejedrejtimin për aq kohë sa ka vendosur gjykata.

2. Ekzekutimi i këtij dënimi plotësues fillon në ditën e marrjes së lejedrejtimit nga organi kompetent.

Neni 48

Ndalimi i qëndrimit në një ose disa njësi administrative

1. Në bazë të urdhrin të ekzekutimit, Policia e Shtetit merr masa për të mos lejuar hyrjen e të dënuarit në njësi administrative të caktuara dhe largimin e tij kur gjendet në to.

2. Në zbatimin e kësaj mase, organet e Policisë së Shtetit në territoret përkatëse kryejnë veprime sikurse për kërkimin e personit, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj.

3. Kur i dënuari në kohën e ekzekutimit të vendimit është prind i vetëm me fëmijë të mitur dhe nuk ka mundësi ta mbajë, bëhet sistemimi i fëmijës në bashkëpunim me shërbimet sociale.

Neni 49

Nxjerrja jashtë territorit

1. Dënimi i nxjerrjes jashtë territorit ekzekutohet nga vetë i dënuari, brenda afatit të caktuar nga prokurori në urdhrin e ekzekutimit, në të kundërt zbatohen rregullat e ekzekutimit të detyruar.

2. Kur i dënuari shtetas i huaj ose person pa shtetësi, ka pasur dënimin me burg dënim kryesor, Policia e Burgjeve, pas përfundimit të kryerjes së dënimit kryesor, ia dorëzon Policisë së Shtetit, e cila kryen procedurat për nxjerrjen jashtë territorit.

3. Kur zbatimi i masës së parashikuar në pikën 2 të këtij neni, nuk mund të realizohet menjëherë, organet përgjegjëse veprojnë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për të huajt.

4. Kur i dënuari nuk mund të kthehet në vendin, shtetas i të cilit është ose në një shtet tjetër, prokurori është i detyruar të sigurojë hyrjen në vendin e tij ose vizë, në të kundërtën paraqet kërkesë për ndryshimin e dënimit plotësues.

5. Në çdo rast për të dënuarit që janë shtetas të huaj prokurori nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për çështjet e drejtësisë, njofton ministrinë përgjegjëse për çështjet e punëve të jashtme për urdhrin e ekzekutimit të këtij dënimi.

Neni 50

Ekzekutimi i dënimit me konfiskim

1. Vendimet penale që parashikojnë konfiskimin e mjeteve dhe përfitimeve të rrjedhura nga vepra penale, zbatohen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara sipas legjislacionit përkatës.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara në ekzekutimin e vendimit merr në dorëzim mjetet e kryerjes së veprës penale dhe pasuritë që janë produkte të veprimtarisë kriminale, që përcaktohen shprehimisht në vendimin e gjykatës dhe i administron ato sipas ligjit.

Neni 51

Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike

1. Dënimi plotësues i heqjes së të drejtës për të ushtruar funksione publike zbatohet nga organi që merr kërkesën për punësim ose organi që ka tagër ta emërojë personin, brenda afatit ndalues të dënimit plotësues të dhënë nga gjykata.

2. Kur detyra në shërbim publik kushtëzohet me licencim, vendimi ekzekutohet nga organi që jep licencën.

Neni 52

Heqja e të drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie

Organi kompetent për dhënien e lejes apo të autorizimit për ushtrimin e një veprimtarie ose mjeshtërie të caktuar, është i detyruar mbi bazën e urdhrin të prokurorit t'i heqë personit të dënuar, për aq kohë sa është parashikuar në dënimin plotësues, të drejtën e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose mjeshtërisë së caktuar dhe njoftimin e organit kompetent financiar.

Neni 53

Heqja e të drejtës për ushtrimin e detyrave drejtuese pranë personave juridikë

Heqja e të drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë, bëhet nga organi që e ka një të drejtë të tillë, sipas statutit ose rregullave përkatëse, i cili njofton edhe organin kompetent financiar.

Neni 54

Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor

1. Për ekzekutimin e detyrimit për publikimin e vendimit gjyqësor, prokurori i vë në dispozicion të dënuarit tekstin e plotë të vendimit ose përmbledhjen e tij, sipas përcaktimit të gjykatës.

2. I dënuari detyrohet të bëjë publikimin e vendimit gjyqësor me shpenzimet e tij, në një ose disa organe të medias, në kohën dhe mënyrën e caktuar në vendim dhe, kur ka pengesa, kërkon ndërhyrjen e prokurorit.

3. Kur organi i përcaktuar shprehimisht nga gjykata kundërshton për shkaqe të arsyeshme ose publikimi në atë organ është i pamundur, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e vendimit ose përcakton vetë mënyrën e publikimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 55

Humbja e përgjegjësisë prindërore

Për ekzekutimin e dënimit plotësues të humbjes së përgjegjësisë prindërore, prokurori ua dërgon për njoftim dhe zbatim vendimin gjyqësor të dënuarit, organeve vendore të Policisë së Shtetit, ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin i mituri, prindit tjetër ose kujdestarit të fëmijës, si dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

KREU VI

EKZEKUTIMI I URDHËRIMEVE TË TJERA

Neni 56

Ekzekutimi i masës mjekësore

1. Për personin e papërgjegjshëm që ka kryer një vepër penale, masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet sipas vendimit të gjykatës në institucionin mjekësor të specializuar të përcaktuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

2. Me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, dërgimi në institucionin mjekësor i personit që dyshohet se ka kryer një vepër penale kryhet:

- a) nga institucioni mjekësor që e ka në trajtim;
- b) nga institucioni mjekësor me ndihmën e Policisë së Shtetit, kur kërkohet nga mjekët që e kanë në trajtim;
- c) nga Policia e Shtetit në rast se i dyshuari i lirë nuk ekzekuton urdhrin vullnetarisht.

3. Masa mjekësore me mjekim të detyruar ambulator ekzekutohet në institucionet mjekësore të vendbanimit të të detyruarit. Kur në to nuk ka specialistë përkatës, shoqërohet në çdo rast nga këto institucione në rrethin më të afërt ku ka të tillë.

4. Kur gjatë ekzekutimit të kësaj mase sillen pengesa nga i detyruari, prokurori urdhëron ekzekutimin e detyruar nga Policia e Shtetit dhe, kur është vendi, i paraqet kërkesë gjykatës për ndryshimin e masës në mjekim të detyruar në një institucion mjekësor të specializuar.

Neni 57

Ekzekutimi i masave edukuese

1. Masa edukuese ekzekutohet në qendra/institucione publike ose private, të cilat janë të pajisura me infrastrukturën dhe personelin e duhur, për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturit dhe të ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Ekzekutimi i këtyre masave bëhet në mënyrë vullnetare nga prindi ose përfaqësuesi ligjor/procedural, bazuar në urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. Kur nuk bëhet ekzekutim vullnetar në datën e caktuar ose kur i mituri nuk ka prindër apo përfaqësues ligjor/procedural, ekzekutimi i masave edukuese bëhet nga punonjësi i Policisë së Shtetit, i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.

3. Punonjësi i Policisë së Shtetit merr masat përkatëse për ekzekutimin e vendimit, me të cilin është marrë një masë edukuese ndaj të miturit, duke e shoqëruar atë së bashku me një punonjës social ose psikolog të specializuar në drejtësinë penale për të mitur.

Neni 58

Ekzekutimi i dënimeve jo me burgim për të miturit

1. Për ekzekutimin e vendimeve jo me burgim për të miturit, prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit Shërbimit të Provës.

2. Për dënimin me kufizim lirie, specialisti i Shërbimit të Provës kryen njoftimin në vendbanimin ose vendqëndrimin e të dënuarit të mitur. Për këtë qëllim, mban procesverbal, i cili i dorëzohet të dënuarit të mitur personalisht ose mbrojtësit të të miturit apo përfaqësuesit të tij ligjor. Specialisti i Shërbimit të Provës cakton kohën dhe vendin e paraqitjes vullnetare, me paralajmërimin se, në rast të mosparaqitjes vullnetare, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.

3. Për dënimet e tjera plotësuese, Shërbimi i Provës vepron në përputhje me parashikimet e bëra në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Neni 59

Ekzekutimi i dënimit me burgim për të mitur

1. Për ekzekutimin e vendimit të dënimit me burgim për të mitur, prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit institucionit të paraburgimit, i cili merr masat për transferimin e të miturit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur.

2. Për të dënuarin e mitur, i cili ka qenë në gjendje të lirë ose në ngarkim të të cilit gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit ka pasur një masë sigurimi të ndryshme nga masa e sigurimit “arrest në burg”, urdhri i ekzekutimit i dërgohet organit vendor të Policisë së Shtetit të vendbanimit ose vendqëndrimin të të dënuarit të mitur. Për këtë qëllim, punonjësi i Policisë së Shtetit mban procesverbal, i cili i dorëzohet të dënuarit të mitur personalisht ose mbrojtësit të të miturit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Punonjësi i policisë cakton kohën dhe vendin e paraqitjes vullnetare, me paralajmërimin se, në rast të mosparaqitjes vullnetare, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.

Neni 60

Ekzekutimi i dënimit me gjobë për të miturin

1. Ekzekutimi i një vendimi dënim me gjobë për të miturin bëhet me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit në masën, afatet dhe mënyrën e pagimit, të përcaktuara në vendimin e gjykatës.

2. Ekzekutimi bëhet nga organi përmbarimor në territorin e të cilit ka vendbanimin i dënuari i mitur, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile për titujt ekzekutivë.

Neni 61

Dënimet kryesore ndaj personave juridikë

1. Kur gjykata ka vendosur dënim me gjobë për personat juridikë, prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit organit përmbarimor të vendit ku ka qendrën personi juridik, i cili vepron sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile për ekzekutimin e detyrueshëm.

2. Kur gjykata ka vendosur mbarimin e personit juridik, prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit:

- a) për shoqëritë tregtare, Qendrës Kombëtare të Biznesit, e cila bën çregjistrimin;
- b) për organizatat jofitimprurëse, gjykatës që ka bërë regjistrimin, e cila bën çregjistrimin.

3. Për vënien në ekzekutim të vendimit, organi përmbarimor njofton organin tatimor ku është regjistruar personi juridik.

Neni 62

Dënimet plotësuese ndaj personave juridikë

Kur gjykata ka vendosur një dënim plotësues ndaj një personi juridik, dënim plotësues ekzekutohet së bashku me dënimin kryesor. Një kopje e urdhrin të ekzekutimit i dërgohet:

a) për shoqëritë tregtare, Qendrës Kombëtare të Biznesit, e cila bën publikimin në regjistër të vendimit në formë të shkurtuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Detyrimisht të dhënat për vendimin pasqyrohen në ekstraktin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit lidhur me subjektin e dënuar;

b) për organizatat jofitimprurëse, gjykatës pranë së cilës është bërë regjistrimi, e cila, për dënimet plotësuese, bën ndryshimet dhe shënimet përkatëse në regjistër.

KREU VII AFATET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE

Neni 63

Afatet e veprimeve të gjykatës

1. Veprimet për vënien në ekzekutim të vendimit penal kryhen menjëherë sapo të jenë plotësuar kushtet ligjore, por jo më vonë se brenda këtyre afateve:

a) për vendimet që përmbajnë dënim me burgim dhe për të cilat nuk është ushtruar ankim, gjykata i dërgon prokurorit kopjen e vendimit të përmbledhur brenda 24 orëve nga e nesërmja e ditës që vendimi merr formë të prerë;

b) vendimet e përmbledhura, që përmbajnë dënime të tjera penale ose urdhërime të tjera, i dërgohen prokurorit nga gjykata jo më vonë se 3 ditë nga marrja formë të prerë.

2. Kur është vendosur pezullimi ose shtyrja e ekzekutimit të vendimit, afatet e mësipërme fillojnë nga data që gjykata anulon pezullimin ose plotësohet afati i shtyrjes.

Neni 64

Afatet e veprimeve të prokurorit

Prokurori kryen veprimet paraprake dhe nxjerr urdhrin e ekzekutimit:

a) për dënimet me burgim ose mjekim të detyrueshëm në institucionet mjekësore, me të paraburgosur, menjëherë pas marrjes së përmbledhjes së vendimit;

b) për vendimet që parashikojnë lirimin e menjëhershëm të të dënuarit dhe zbatimin e një dënimi alternativ, menjëherë pas marrjes së përmbledhjes së vendimit;

c) për dënimet me burgim për të gjykuarit në gjendje të lirë jo më vonë se 72 orë nga marrja e vendimit;

ç) për dënimet me gjobë, kur është dhënë vetëm dënim plotësues, dhe për urdhërimet e tjera të gjykatës brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit;

d) për dënimet plotësuese që ekzekutohen njëkohësisht me dënimin kryesor, në të njëjtën kohë;

dh) për dënimet plotësuese të tjera pas përfundimit të dënimit kryesor;

e) për dënimet ndaj personave juridikë brenda 5 ditëve nga marrja e përmbledhjes së vendimit.

Neni 65

Afatet e fillimit të ekzekutimit

1. Urdhrat e ekzekutimit për vendime penale me burgim dhe masë mjekësore me mjekim të detyrueshëm për personat e paraburgosur ekzekutohen menjëherë.

2. Urdhrat e ekzekutimit për vendime me ekzekutim të menjëhershëm për personat e paraburgosur ekzekutohen menjëherë nga marrja e urdhrin.

3. Për urdhrat e ekzekutimit me dënime ose urdhërime të tjera, ekzekutimi duhet të fillojë menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga marrja e tij.

4. Urdhri i ekzekutimit për vendimet penale ndaj personave juridikë ekzekutohet brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Neni 66

Shtyrja e afateve

Kur pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit gjykata vendos pezullimin ose shtyrjen e ekzekutimit, afatet e parashikuara në nenin 65 të këtij ligji fillojnë nga data e anulimit të pezullimit, plotësimit të periudhës së shtyrjes ose ndërprerjes së tyre me vendim të gjykatës.

PJESA E KATËRT

KONTROLLI NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE

KREU I

KONTROLLI I GJYKATËS DHE I PROKURORIT

Neni 67

Kompetenca

1. Kontrolli procedural për ekzekutimin e vendimeve bëhet nga prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin. Kur ekzekutimi i vendimit bëhet në një rreth të ndryshëm nga ai i gjykatës që ka dhënë vendimin, kompetent për kontrollin procedural është prokurori i rrethit ku kryhet ekzekutimi.

2. Gjkata që ka dhënë vendimin ose gjykata e vendit ku ekzekutohet dënimi, për çështjet në kompetencë të saj që dalin gjatë ekzekutimit ka të drejtë të kërkojë njoftime nga prokurori dhe organi ku ekzekutohet vendimi dhe, kur e sheh me vend, kontrollon drejtpërdrejt rregullsinë e ekzekutimit.

Neni 68

Format e kontrollit të prokurorit

Prokurori realizon kontrollin nëpërmjet:

- a) marrjes së njoftimit për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit nga organi përkatës;
- b) shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të të arrestuarve, të paraburgosurve, të dënuarve dhe mbrojtësve të tyre;
- c) kërkit të informacioneve dhe verifikimeve të drejtpërdrejta për dokumente ose në vendin e kryerjes së dënimit në prani të personit zyrtar përkatës;
- ç) marrjes dhe verifikimit të njoftimeve për fakte dhe rrethana që ndikojnë në ekzekutimin e vendimeve;
- d) marrjes së mendimit të specialistëve të fushave të ndryshme;
- dh) bashkëpunimit me kontrollin e brendshëm të organit ku ekzekutohet vendimi ose të institucioneve shtetërore të kontrollit administrativ.

Neni 69

Dokumentimi i verifikimeve

1. Prokurori mban procesverbal për verifikimet që bëhen në vende ku ekzekutohet vendimi ose në vende të tjera. Personi zyrtar i pranishëm ka të drejtë të pasqyrojë në procesverbal pretendimet e tij.

2. Për verifikimet për ankesën e të dënuarit apo mbrojtësit të tij, ky i fundit duhet të jetë i pranishëm kur paraqet kërkesë.

3. Kur prokurori e shih të nevojshme, tërheq dokumente, sende ose objekte që konfirmojnë rezultatin e verifikimit, duke i pasqyruar në procesverbal, kopje e të cilit u lihet të interesuarve.

Neni 70

Veprimet e prokurorit për konstatimet pas kontrollit

1. Prokurori i paraqet kërkesë gjykatës për rivendosjen e rregullit të shkelur ose njohjen e së drejtës të të dënuarit për rastet në kompetencë të saj.

2. Në rastet e tjera prokurori ndërhyr në organet e ngarkuara me ekzekutimin e vendimit ose në organe të tjera kompetente për rivendosjen e ligjit ose të drejtës së cenuar, duke caktuar edhe afatet përkatëse.

3. Kur nuk ka pengesë ligjore, prokurori urdhëron rivendosjen e menjëhershme të ligjit dhe të së drejtës së shkelur.

Neni 71

Përgjegjësia për shkeljet e konstatuara

1. Kur është rasti, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 45 të këtij ligji, prokurori fillon ndjekje penale, ose paraqet kërkesë në organin kompetent për vënien para përgjegjesisë disiplinore e administrative ose të zhdëmtimit ndaj personave që kanë lejuar apo kanë kryer shkelje.

2. Kërkesa shqyrtohet detyrimisht nga organi kompetent dhe përfundimi i njoftohet prokurorit.

KREU II

KONTROLLE TË TJERA

Neni 72

Kontrolli i brendshëm

1. Organet dhe institucionet ku ekzekutohet vendimi penal ose që janë të ngarkuara me mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimit, si dhe organet eprore të tyre, në kuadrin e kontrollit të brendshëm, bëjnë, sipas rastit, verifikimet përkatëse.

2. Organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, brenda kompetencës, për konstatimet që dalin nga verifikimet, marrin masat përkatëse, ose në të kundërtën kërkojnë ndërhyrjen e prokurorit dhe, kur është rasti, nëpërmjet tij kërkojnë shqyrtimin e çështjes nga gjykata.

Neni 73

Të drejta të organeve të tjera në ekzekutimin e vendimeve penale

1. Organet shtetërore, përfaqësues të institucioneve dhe organizatave jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, mund të kërkojnë informacione dhe sqarime në vendet e ekzekutimit të dënimeve për rregullsinë e ekzekutimit të vendimit dhe respektimin e të drejtave të të dënuarit, duke rekomanduar marrjen e masave përkatëse dhe, kur e vlerësojnë, mund të kërkojnë ndërhyrjen e prokurorit.

2. Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim, për të cilat zbatohen kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë.

KREU III
KOMISIONI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Neni 74
Funksionet

1. Komisioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale është organ këshillimor, i krijuar për të ndjekur zbatimin e ligjit në ekzekutimin e dënimeve dhe mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve.
2. Komisioni ngrihet pranë ministrit të Drejtësisë dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë vendin.

Neni 75
Përbërja e Komisionit

1. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët caktohen një herë në katër vjet, pa të drejtë ricaktimi.
2. Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Prokurori i Përgjithshëm caktojnë si anëtarë nga një person, që nuk ushtron funksione publike, dhe që ka jo më pak se 15 vjet përvojë të njohur pune në fushën e së drejtës ose në administratën publike.
3. Ministrat që mbulojnë arsimin, financat dhe shëndetësinë caktojnë nga një anëtar prej punonjësve të tyre, me kusht që të jenë specialistë në profilet përkatëse.
4. Ministri i Drejtësisë cakton një anëtar që nuk ka funksione publike, por që plotëson kriteret e një magjistrati.
5. Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë cakton një anëtar nga anëtarësia e saj.
6. Kryetari i Komisionit dhe zëvendësi zgjidhen nga mbledhja e anëtarëve.

Neni 76
Statusi i anëtarëve

1. Anëtarët e Komisionit gjatë ushtrimit të detyrave kanë atributet dhe përgjegjësitë ligjore të nëpunësit publik. Publikimi i të dhënave nga anëtarët bëhet me leje të ministrit të Drejtësisë. Në çdo rast zbatohen rregullat për ruajtjen e sekretit shtetëror.
2. Anëtarët e Komisionit rezervojnë të drejtën të japin informacione për veprimtarinë dhe konstatimet në organin që i ka caktuar.

Neni 77
Veprimtaria e Komisionit

1. Komisioni mbledhet rregullisht një herë në tre muaj dhe në raste të veçanta, me kërkesë të kryetarit, edhe më parë.
2. Mbi bazën e ankesave ose njoftimeve të paraqitura, Komisioni ose anëtari i autorizuar prej tij ka të drejtë të kryejë verifikime, edhe pa paralajmërim, në institucionet e dënimit, të marrë takim në çdo kohë me të burgosur të veçantë, të kërkojë sqarime dhe të këqyrë dokumentet dhe mjediset, si dhe të bëjë verifikimet e tjera të nevojshme.
3. Veprimet kryhen në prani të drejtuesit të institucionit ose të ngarkuarit prej tij, me përjashtim të takimit me të burgosurin, që mund të bëhet edhe pa praninë e tyre.
4. Në rastet kur konstaton shkelje, Komisioni rekomandon marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e ligjit apo të së drejtës së shkelur dhe i parashtroi ministrit të Drejtësisë konstatimet, duke i kërkuar marrjen e masave përkatëse. Ministri i Drejtësisë duhet të kthejë përgjigje për masat e marra brenda 30 ditëve.

5. Kur marrja e masave është në kompetencë të prokurorit dhe gjykatës, ministri i Drejtësisë i paraqet materialet prokurorit kompetent.

6. Kur nga konstatimet çmohet se ka vend për ndryshime, shtesa ose për akte të reja ligjore e nënligjore, komisioni i bën propozimet përkatëse ministrit të Drejtësisë.

7. Ministri i Drejtësisë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve krijon kushtet e nevojshme për veprimtarinë e Komisionit.

8. Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve, për shpërblimin e tyre, si dhe rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Komisionit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 78

Zbatimi i ligjit

1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen organet dhe subjektet e përcaktuara në këtë ligj.

2. Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe ministri përgjegjës për rendin publik marrin masat për të siguruar zbatimin e këtij ligji.

Neni 79

Akte nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 8 të nenit 77 të këtij ligji.

Neni 80

Shfuqizime

Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, shfuqizohet në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 81

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.6.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11549, datë 16.7.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.